



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

Lipjanit i konfirmohet edhe një herë si top komuna më transparente në Kosovë

VLERËSIMI I TRANSPARENCËS SË KOMUNAVE JANAR - QERSHOR 2021

Komuna	Pikët	Përqindje
Rahovec	83	94.32
Lipjan	81	92.05
Mitrovicë e Jugut	81	92.05
Pejë	81	92.05
Drenas	78	88.64
Gjakovë	77	87.50
Skenderaj	75	85.23

Kryetari Imri Ahmeti pritet në mënyrë solemne në Komunë

Punëtoret e administratës së Komunës së Lipjanit kanë pritur në mënyrë solemne Kryetarin Imri Ahmeti i cili do të qeverisë Komunën e Lipjanit edhe për katër vitet e ardhshme pas fitores së zgjedhjeve të 17 tetorit.

Kryetari Ahmeti ka falënderuar të gjithë qytetarët pa dallim për besimin e dhënë dhe është zotuar se do të vazhdojë më punë të mira për Lipjanin.



Nënkryetari Komunës së Lipjanit, Lulzim Qerimi së bashku me Komandantin e Stacionit të Policisë në Lipjan, Naser Sinani kanë takuar të rinjtë e komunitetit ku kishte për qëllim rritjen dhe pjesëmarrjen e të rinjëve që vijnë nga komuniteti në Policinë e Kosovës.

Gjatë këtij takimi nga ana e pjesëtareve të Policisë së Kosovës është treguar në detaje mënyra e aplikimit dhe mundësisë për të qenë pjesë e Policisë së Kosovës.



FSK dhuron 12 mijë maska për Komunën e Lipjanit

FSK ka dhuruar 12 mijë maska për Komunën e Lipjanit, ky donacion do të shpërndahet në të gjithë shkollat e Komunës së Lipjanit.

Me këtë rast, Drejtoresha Arsimit në Komunën e Lipjanit, Elmaze Behluli ka falënderuar FSK-në për këtë donacion të cilat maska do të shpërndahen në të gjitha shkollat e Lipjanit.



Komuna e Lipjanit është furnizuar me vaksinat sezonale kundër gripit sezonal. Vaksinimi do të realizohet çdo ditë të punës, në sallën e sporteve "Better Life" ku administrohet edhe vaksina antiCovid.

Kjo nuk pengon në asnjë mënyrë njëra tjetrën dhe sipas prospektit të MSH dhe Institutit mund të aplikohen dyjat njëkohësisht!

Grupet me prioritet për vaksinim janë:

- punëtorët shëndetësorë
- personat mbi 65 vjeç
- personat me sëmundje kronike,
- shtatzënat,
- fëmijët me imunitet të dobësuar.



Vaksinat sezonale kundër gripit sezonal.

GRUPET PRIORITARE PËR VAKSINIM KUNDËR GRIPIT DO TË JENË:

- PUNËTORËT SHËNDETËSORË
- PERSONAT MBI 65 VJEÇ
- PERSONAT ME SËMUNDJE KRONIKE
- SHTATZËNAT
- FËMIJËT ME IMUNITET TË DOBËSUAR



Vaksinimi do të realizohet në sallën e sporteve "Better Life"

Tetori Rozë, muaji i ndërgjegjësimit për Kancerin e Gjirit

Nënkryetari i Komunës, Fauz Xhemajli është bashkuar aktivitetit të organizuar nga Grupi i Grave ne Lipjan, udhëhequr nga Hyra Bytyçi, për të dhënë mesazhin se kanceri i gjirit mund të shërohet, mjafton të zbulohet me kohë.

Ky aktivitet kishte për qëllim ndërgjegjësimin dhe diagnostikimin më të hershëm të kancerit të gjirit, si dhe marrjen e masave preventive.

**TETORI ROZË, MUAJI I
NDËRGJEGJËSIMIT PËR
KANCERIN E GJIRIT**



Tetori - Muaji i mundësive të barabarta

Në kuadër të aktiviteteve “Tetori - Muaji i mundësive të barabarta profesionale për personat me aftësi të kufizuara”, në Komunën e Lipjanit ka fillua promovimi kësaj fushate e cila synon ngritjen e vetëdijes për bashkëpunim institucional dhe tek qytetaret e komunës sonë për mbështetje pa rezervë e të fuqishme personave me aftësi të kufizuara (PAK).

Në mbështetje financiare nga Kryetari Imri Ahmeti dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, të oraganizuar nga Njësi për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore në bashkëpunim me shoqatat “Handikos” dhe OMPAK për dy ditë radhazi do të mbahen aktivitetet me qëllim të integritit të PAK-ve në institucionet komunale me ç’rast 20-të përsosna do të jenë pjesë e këtij aktiviteti i cili po mbahet në Bibliotekën e Qytetit dhe në sektorët e Drejtoratit për Kulturë Rini dhe Sport.



**Tetori, muaji i ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit-
“Kanceri i gjirit mund të shërohet, mjafton të
zbulohet me kohë”!**

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Lipjan, gjegjësisht sektori diagnostikues Radiologjisë, ofron shërbimin e Ultrazërit të gjirit (pa pagësë) çdo ditë pune duke filluar nga ora 8:00 mëngjes deri në 11:00 (prej 11:00 pastaj është shërbimi i Rtg për pacientët Covid-19 pozitiv apo të dyshuar në COVID-19.

Drejtoresha e Shëndetësisë dhe e Përkujdesjes Merita Bytyqi ka thënë se edhe në këtë vit sikurse edhe në vitet e kaluara në kuadër të muajit Tetor, muaji rozë - ndërgjegjësim për kancerin e gjirit, Komuna e Lipjanit ka qenë në mbështetje morale edhe profesionale në kuptimin e ngritjes së nivelit të vetëdijes dhe ndërgjegjësimit të komunitetit në këtë rast gra, në formën e mbajtjes së ligjëratave edukuese, e shumë aktivitete tjera për zbulim dhe diagnostikim sa më të hershëm dhe për parandalim!

**Drejtoresha Merita Bytyqi po ashtu u ka bërë thirrje gjitha grave të cilat kanë dyshime apo janë të ekspozuara faktorëve të rrezikut, të mos hezitojnë të lajmërohen në QKMF!
Së bashku, jemi më të fortë!**



VAKSINOHU!



#Bashkëiadalim



LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET